



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA Durrës  
KËSHILLI BASHKIAK

**NJOFTIM PËR RENDIN E DITËS**  
**Mbledhje Jashtë Rradhe**  
**Me Mjete Të Komunikimit Elektronik**

Në mbështetje të nenit 57 pika 2/c të Ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, të nenit 50, të Rregullores së Funksionimit të Këshillit Bashkiak Durrës, Aktit Normativ të Këshillit Ministrave nr.3, datë 15.03.2020 “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19“, neni 5 “Vendimmarrja nga Organet Kolegjiale,, Këshilli Bashkiak Durrës,

**NJOFTON:**

DITËN E MËRKURË, DATË 14.04.2021, ORA 12:00, KËSHILLI DO TË MBAJË NJË MBLEDHJE JASHTË RADHE NËPËRMJET MJETEVE TË KOMUNIKIMIT ELEKTRONIK, ME KËTË REND DITE:

****	MIRATIMI I RENDIT TË DITËS TË MBLEDHJES
1. Shqyrtim dhe miratim projekt-vendimi	PËR MIRATIMIN E FAMILJEVE PËRFITUESE TË NDIHMËS EKONOMIKE NGA FONDI I KUSHTËZUAR PËR BLLOK NDIHMËN EKONOMIKE DERI 6% DHE FONDI NGA TË ARDHURAT E BASHKISË, PËR MUAJIN MARS 2021
2. Shqyrtim dhe miratim projekt-vendimi	PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË VKB NR.55, DATË 26.06.2020, NR. 64, DATË 07.07.2020, NR. 70, DATË 20.07.2020, NR. 81, DATË 10.08.2020 PËRSA I PËRKET NDRYSHIMIT TË LISTAVE EMËRORE TË FAMILJEVE PËRFITUESE TË GRANTIT PËR RIKONSTRUKSIONIN E BANESAVE TË DËMTUARA SI PASOJË E DËMEVE TË SHKAKTUARA NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019,

	PËR SHKAK TË NDRYSHIMIT TË KATEGORISË SË DËMIT TË SHKAKTUAR
3. Shqyrtim dhe miratim projekt- vendimi	PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I RINDËRTIMIT NË NJËSITË ADMINISTRATIVE NR. 2, 4, 5, 6, RRASHBULL, SUKTH, KATUND I RI, ISHËM, MANËZ, BASHKIA Durrës, QË DO TË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI I PROÇESIT TË RINDËRTIMIT PËR BANESAT INDIVIDUALE TË DËMTUARA NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019
4. Shqyrtim dhe miratim projekt- vendimi	PËR MIRATIMIN E LISTËS SË KATËRT TË 44 SUBJEKTEVE PËRFITUESE, TË CILËT DO TË PËRFITOJNË MASËN E GRANTIT TË RINDËRTIMIT TË BANESAVE INDIVIDUALE TË DËMTUARA NGA TËRMETI I DATËS 26 NËNTOR 2019, SIPAS PROJEKTIT MODEL
5. Shqyrtim dhe miratim projekt- vendimi	PËR MIRATIMIN E LISTËS SË FAMILJEVE PËRFITUESE TË SUBVENCIONIMIT TË QIRASË TË MBETURA TË PASTREHA SI PASOJË E SHEMBJES SË BANESAVE TË TYRE NË ZBATIM TË PROJEKTIT TË RINDËRTIMIT SHESHI DYZH, ZONA 4 Durrës SPITALLË
6. Shqyrtim dhe miratim projekt- vendimi	PËR MIRATIMIN E DHËNIES SË NDIHMËS FINANCIARE, SIPAS LISTËS SË NJËMBËDHJETË ME SUBJEKTET PËRFITUES TË PROGRAMIT TË GRANTIT PËR RIKONSTRUKSIONIN E BANESAVE TË DËMTUAR SI PASOJË E DËMEVE SHKAKTUAR NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019
7. Shqyrtim dhe miratim projekt- vendimi	PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË VKB NR.55, DATË 26.06.2020, NR. 64, DATË 07.07.2020, NR. 70, DATË 20.07.2020, NR. 81, DATË 10.08.2020, VKB NR.100, DATË 30.09.2020, VKB NR. 129, DATË 24.12.2020, VKB NR. 15, DATË 22.02.2021 SI DHE VKB NR. 11, DATË 04.02.2021 PËRSA I PËRKET NDRYSHIMIT TË LISTAVE EMËRORE TË FAMILJEVE PËRFITUESE TË GRANTIT TË RIKONSTRUKSIONIT PËR BANESAT E DËMTUARA SI PASOJË E DËMEVE TË SHKAKTUARA NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019, PËR SHKAK TË NDRYSHIMIT TË KATEGORISË SË DËMIT TË SHKAKTUAR

Në mbështetje të nenit 5 të Aktit Normativ të Këshillit Ministrave nr.3, datë 15.03.2020 “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19“, të nenit 33, neni 34 pika 1, neni 77 pika 8, të Rregullores së Funksionimit të Këshillit të Bashkisë Durrës, anëtarët e Komisioneve të Këshillit Bashkiak pasi

shqyrtojnë me njëri tjetrin elektronikisht projektvendimin përkatës, dërgojnë me email propozimin e tyre (RAPORTIN) mbi projektvendimin sipas grafikut të mëposhtëm.

**DATA 13-14.04.2021**

Pika 1, do të shqyrtohet nga:

- Komisioni i Barazisë Gjinore dhe Mirëqënies Sociale  
dhe dërgojnë me e-mail Raportin e tyre për këtë projektvendim brenda orës 11.00 të datës 14.04.2021

Pikat 2,3,5,7 do të shqyrtohen nga:

- Komisioni i Rregullores, Çështjeve Juridike
- Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike  
dhe dërgojnë me e-mail Raportin e tyre për këtë projektvendim brenda orës 11.00 të datës 14.04.2021

Pikat 4,6 do të shqyrtohen nga:

- Komisioni i Buxhetit, Financës dhe Taksave-Tarifave
- Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike  
dhe dërgojnë me e-mail Raportin e tyre për këtë projektvendim brenda orës 11.00 të datës 14.04.2021

**SEKRETARE KËSHILLIT BASHKIAK DURRËS**

**Dorina Milja**